

KOMENTE TË PËRGJITHSHME

Mbi raportin e monitorimit të

Shërbimit Informativ të Shtetit

për tremujorin e tretë të vitit 2014

1. Karakteristikat kryesore të performancës.

Shërbimi Informativ i Shtetit, për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet publike sipas një programi buxhetor të miratuar, e konkretisht:

1. Programi “Veprimtaria Informative Shtetërore”

Mbështetur në informacionin e paraqitur nga Shërbimi Informativ i Shtetit mbi monitorimin e buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2014, si dhe të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, realizimi i treguesve buxhetorë për këtë institucion, paraqitet si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

	Emërtimi	Plani 2014	Fakti 2014	Raporti me Totalin e Shpenzimeve	% e realizimit
1.	Shpenzime Korente	1,382,665	942,479	99.7%	68.16%
1.1	Personeli	994,000	700,134	74.0%	70.44%
1.2	Operative	388,665	242,345	25.6%	62.35%
2	Shpenzime kapitale	50,000	3,012	0.3%	6.02%
2.1	Financim i brendshëm	50,000	3,012	0.3%	6.02%
2.2	Financim i huaj	0	0	0.0%	
3	SHUMA	1,432,665	945,491	100.0%	66.00%
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit		0	0.0%	
4	TOTALI	1,432,665	945,491	100.0%	66.00%

Sikurse evidentohet edhe më sipër, shpenzimet korente përbëjnë 100% të shpenzimeve faktike të periudhës 9-mujore. Shpenzimet për personelin zënë vendin kryesor me 74% të shpenzimeve faktike, ndërkohë që operativet përbëjnë 26% të shpenzimeve. Në fakt, gjatë periudhës 9-mujore, sipas informacionit të paraqitur nga SHISH, janë prokuruar dhe lidhur rreth 95 % e kontratave për mallra dhe shërbime. Ndërkohë, investimet, paraqesin një nivel realizimi minimal të planit vjetor, me vetëm 6 përqind. Vlen të theksohet se pavarësisht vonësës, në vijim të përfundimit të procesit të prokurimit, janë lidhur kontratat për shërbimet dhe investimet kryesore, të cilat priten të materializohen në tremujorin e fundit të vitit.

Për 9-mujorin e vitit 2014, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si më poshtë.

Emërtimi i Programit	SHPENZIMET KORENTE			SHPENZIMET KAPITALE			Totali i shpenzimeve		% e realizimi
	PLAN	FAKT	Realizimi	PLAN	FAKT	Realizimi	Plan	Fakt	
Veprimtaria Informativ Shtetërore	1,382,665	942,479	68.2	50,000	3,012	6.0	1,432,665	945,491	66.0

Burimi: Ministria e Financave

Sikurse shprehur më sipër, shpenzimet korente, janë realizuar në masën 68% dhe ato kapitale në masën 6% të planit vjetor. Në tërësi, Shërbimi Informativ i shtetit, paraqet një realizim të buxhetit me rreth 66 % për periudhën 9-mujore, të shprehur në terma vjetore, duke reflektuar kështu nivelin e ulët të realizimit të shpenzimeve kapitale dhe ato operative.

2. Performanca dhe statusi i produkteve kryesore

Në programin e vetëm buxhetor "Veprimtaria Informativ Shtetërore", janë parashikuar gjithsej 15 produkte, të cilët, në raport me planin e periudhës 9-mujore, paraqesin një performancë relativisht të mirë, pavarësisht se një pjesë e tyre janë ende në fazën e prokurimit. Gjithsesi, konstatohet se, kërkohet më shumë punë lidhur me konceptimin dhe emërtimin e produkteve, konform objektit të kompetencës së këtij institucioni.

3. Krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të SHISH me të dhënat e Thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat faktike të raportit të hartuar nga Shërbimi Informativ Shtetëror, të krahasuara me të dhënt e nxjerra nga sistemi i thesarit i Ministrisë së Financave.

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	SHISH	MF	Dif	SHISH	MF	Dif.	SHISH	MF	Dif
Veprimtaria Informativ Shtetërore	942,479	942,479	0	3,012	3,012	0	945,491	945,491	0

Burimi: Ministria e Financave, SHISH, të dhënat në mijë lekë

Ashtu sikurse paraqitur në tabelën e mësipërme, të dhënat e përdorura nga SHISH për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për tremujorin e parë të vitit 2014, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit.

4. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.

Për programin buxhetor Veprimtaria Informativ e Shtetit, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në mijë lekë

Programet	Buxheti	Buxheti me	Diferenca
-----------	---------	------------	-----------

	filleshtar 2014	ndryshime	
Veprimtaria Informativë Shtetërore	1.438.300	1,432,665	-5.635
Totali i institucionit	1.438.300	1,432,665	-5.635

Ndryshimet prej 5.6 milion lekë në planin e buxhetit, shpjegohen me ndryshimet në fondet e SHISH-it si pasojë e miratimit të përdorimit të fondit të veçantë të dhënë në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në vijim të kërkesave të paraqitura nga Institucioni, dhe zbatimit të Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

5. Komentë të tjera

- Kërkohen më shumë përpjekje lidhur me konceptimin dhe emërtimin e produkteve, konform objektit të kompetencës së këtij institucioni.
- SHISH ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, raportin e monitorimit të buxhetit për tremujorin e parë të vitit 2014.